LIGJ
Nr. 93/2026

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS KUADËR TË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR INTELIGJENCËN ARTIFICIALE, TË DREJTAT E NJERIUT, DEMOKRACINË DHE SHTETIN E SË DREJTËS

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa kuadër e Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës, lidhur në Vilnius, më 5 shtator 2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.9.2026.

Shpallur me dekretin nr. 512, datë 6.10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

KONVENTA KUADËR E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR INTELIGJENCËN ARTIFICIALE, TË DREJTAT E NJERIUT, DEMOKRACINË DHE SHTETIN E SË DREJTËS

(E lidhur në Vilnius, më 5 shtator 2024)

Preambulë

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe palët e tjera nënshkruese,

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrijë një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, bazuar veçanërisht në respektin për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës;

duke njohur vlerën e nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet palëve të kësaj Konvente dhe të shtrirjes së këtij bashkëpunimi me shtete të tjera që ndajnë të njëjtat vlera;

duke qenë të vetëdijshëm për zhvillimet e shpejta në shkencë dhe teknologji, dhe ndryshimet e thella të sjella përmes aktiviteteve brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale, të cilat kanë potencialin të nxisin prosperitetin njerëzor, si dhe mirëqenien individuale dhe shoqërore, zhvillimin e qëndrueshëm, barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave, si dhe qëllime dhe interesa të tjerë të rëndësishëm, duke rritur përparimin dhe inovacionin;

duke njohur se aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale mund të ofrojnë mundësi të paprecedenta për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës;

të shqetësuar se disa aktivitete brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale mund të rrezikojnë dinjitetin njerëzor dhe autonominë individuale, të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës;

të shqetësuar për rreziqet e diskriminimit në kontekstet digjitale, veçanërisht ato që përfshijnë sistemet e inteligjencës artificiale dhe efektin e tyre të mundshëm në krijimin ose përkeqësimin e pabarazive, përfshirë ato të përjetuara nga gratë dhe individët në situata sensitive, në lidhje me gëzimin e të drejtave të tyre të njeriut dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë, të barabartë dhe efektive në çështjet ekonomike, sociale, kulturore dhe politike;

të shqetësuar për keqpërdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale dhe duke kundërshtuar përdorimin e këtyre sistemeve për qëllime represive, në shkelje të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë nëpërmjet praktikave të mbikëqyrjes së paligjshme dhe censurës që prishin privatësinë dhe autonominë individuale;

të vetëdijshëm për faktin se të drejtat e njeriut, demokracia dhe shteti i së drejtës janë të ndërthurura në thelb;

të bindur për nevojën për të krijuar, si çështje prioriteti, një kuadër ligjor të zbatueshëm globalisht që përcakton parime dhe rregulla të përgjithshme të përbashkëta që rregullojnë aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale, i cili ruan efektivisht vlerat e përbashkëta dhe shfrytëzon përfitimet e inteligjencës artificiale për promovimin e këtyre vlerave në një mënyrë që nxit inovacionin e përgjegjshëm;

duke e njohur nevojën për të promovuar edukimin digjital, njohuritë dhe besimin në projektimin, zhvillimin, përdorimin dhe tërheqjen e sistemeve të inteligjencës artificiale;

duke njohur natyrën kuadër të kësaj Konvente, e cila mund të plotësohet me instrumente të tjera për të trajtuar çështje specifike, në lidhje me aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale;

duke theksuar se kjo Konventë synon të trajtojë sfida specifike që lindin gjatë të gjithë ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale dhe të nxisë marrjen në konsideratë të rreziqeve dhe ndikimeve më të gjera që lidhen me këto teknologji, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shëndetin njerëzor dhe mjedisin, si dhe aspektet socio-ekonomike, si punësimi dhe puna;

duke theksuar përpjekjet përkatëse për të avancuar kuptimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar mbi inteligjencën artificiale nga organizata dhe forume të tjera ndërkombëtare dhe mbikombëtare;

duke pasur parasysh instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në fuqi, si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e vitit 1950 (ETS Nr. 5), Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, i vitit 1966, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i vitit 1966, Karta Sociale Evropiane e vitit 1961 (ETS Nr. 35), si dhe protokollet e tyre përkatëse, dhe Karta Sociale Evropiane (e Rishikuar) e vitit 1996 (ETS Nr. 163);

duke pasur, gjithashtu, parasysh Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve të vitit 1989 dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të vitit 2006;

duke pasur, gjithashtu, parasysh të drejtat e privatësisë së individëve dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të zbatueshme dhe të dhëna, për shembull, nga Konventa e vitit 1981 për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (ETS Nr. 108) dhe protokollet e saj;

duke pohuar angazhimin e palëve për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës dhe për të nxitur besueshmërinë e sistemeve të inteligjencës artificiale nëpërmjet kësaj Konvente,

kanë rënë dakord, si më poshtë:

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Dispozitat e kësaj Konvente synojnë të garantojnë që aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale të jenë plotësisht në përputhje me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

2. Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa të përshtatshme legjislative, administrative ose masa të tjera për të zbatuar dispozitat e përcaktuara në këtë Konventë. Këto masa do të vlerësohen dhe diferencohen sipas nevojës, në përputhje me shkallën dhe probabilitetin e shfaqjes së ndikimeve negative mbi të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës gjatë të gjithë ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale. Kjo mund të përfshijë masa specifike ose horizontale që zbatohen, pavarësisht nga lloji i teknologjisë që përdoret.

3. Për të garantuar zbatimin efektiv të dispozitave të saj nga palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm mbikëqyrës dhe parashikon bashkëpunim ndërkombëtar.

Neni 2

Përkufizimi i sistemeve të inteligjencës artificiale

Për qëllimet e kësaj Konvente, "sistem i inteligjencës artificiale" nënkupton një sistem të bazuar në makineri që për qëllime të qarta ose të nënkuptuara, specifikon nga të dhënat që merr, mënyrën si të gjenerojë rezultate, të tilla si: parashikimet, përmbajtjet, rekomandimet ose vendimet që mund të ndikojnë në mjedise fizike ose virtuale. Sistemet e ndryshme të inteligjencës artificiale ndryshojnë në nivelet e tyre të autonomisë dhe përshtatshmërisë pas përdorimit.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Fusha e zbatimit të kësaj Konvente përfshin aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale që kanë potencialin të ndërhyjnë në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës si më poshtë:

a) Çdo palë do të zbatojë këtë Konventë në aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale të ndërmarra nga autoritetet publike ose grupe private interesi që veprojnë në emër të tyre;

b) Çdo palë do të trajtojë rreziqet dhe ndikimet që lindin nga aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale nga grupet private të interesit, sane masën që nuk mbulohen në nënparagrafin "a", në një mënyrë që është në përputhje me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

Çdo palë do të specifikojë në një deklaratë të dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, se si synon të zbatojë këtë detyrim, ose duke zbatuar parimet dhe detyrimet e përcaktuara në kapitujt II deri në VI të kësaj Konvente, në aktivitetet e grupeve private të interesit ose duke marrë masa të tjera të përshtatshme për të përmbushur detyrimin e parashikuar në këtë nënparagraf. Palët mund të ndryshojnë deklaratat e tyre në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë.

Kur zbatohet detyrimi sipas këtij nënparagrafi, një palë nuk mund të shmangë ose kufizojë zbatimin e detyrimeve të saj ndërkombëtare për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

2. Një pale nuk do t'i kërkohet të zbatojë këtë Konventë për aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale që lidhen me mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare, duke e ditur se këto aktivitete zhvillohen në një mënyrë që është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme, duke përfshirë detyrimet e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me respekt për institucionet dhe proceset e saj demokratike.

3. Pavarësisht parashikimeve të nenit 13 dhe nenit 25, pika 2, kjo Konventë nuk do të zbatohet për aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit, në lidhje me sistemet e inteligjencës artificiale që nuk janë vënë ende në dispozicion për përdorim, përveç nëse aktivitetet e testimit ose të ngjashme kryhen në një mënyrë që mund të ndërhyjnë në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

4. Çështjet që lidhen me mbrojtjen kombëtare nuk hyjnë brenda fushës së zbatimit të kësaj Konvente.

KREU II
DETYRIMET E PËRGJITHSHME

Neni 4
Mbrojtja e të drejtave të njeriut

Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa për të garantuar që aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale të jenë në përputhje me detyrimet për të mbrojtur të drejtat e njeriut, të sanksionuara sipas të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme dhe të drejtës së saj të brendshme.

Neni 5
Integriteti i proceseve demokratike dhe respekti për shtetin e së drejtës

1. Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa që synojnë të garantojnë që sistemet e inteligjencës artificiale të mos përdoren për të cenuar integritetin, pavarësinë dhe efektivitetin e institucioneve dhe proceseve demokratike, duke përfshirë parimin e ndarjes së pushteteve, respektimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe aksesin në drejtësi.
2. Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa që synojnë të mbrojnë proceset e saj demokratike në kontekstin e aktiviteteve brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale, duke përfshirë aksesin e drejtë të individëve dhe pjesëmarrjen në debatet publike, si dhe aftësinë e tyre për të formuar lirisht opinione.

KREU III
PARIMET E LIDHURA ME AKTIVITETET BRENDA CIKLIT TË JETËS SË SISTEMEVE TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Neni 6
Qasja e përgjithshme

Ky kre përcakton parimet e përgjithshme të përbashkëta që çdo palë duhet të zbatojë në lidhje me sistemet e inteligjencës artificiale në një mënyrë që është e përshtatshme për sistemin e saj ligjor të brendshëm dhe detyrimet e tjera të kësaj Konvente.

Neni 7
Dinjiteti i njeriut dhe autonomia individuale

Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa për të respektuar dinjitetin e njeriut dhe autonominë individuale, në lidhje me aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale.

Neni 8
Transparenca dhe mbikëqyrja

Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa për të garantuar që kërkesat e mjaftueshme për transparencë dhe mbikëqyrje, të përshtatura për kontekstet dhe rreziqet specifike, janë të vendosura, në lidhje me aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale, duke përfshirë identifikimin e përmbajtjes së gjeneruar nga sistemet e inteligjencës artificiale.

Neni 9
Llogaridhënia dhe përgjegjësia

Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa për të garantuar llogaridhënien dhe përgjegjësinë për ndikimet negative në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës që rezultojnë nga aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale.

Neni 10
Barazia dhe mosdiskriminimi

1. Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa, me qëllim që aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale të respektojnë barazinë, duke përfshirë barazinë gjinore dhe ndalimin e diskriminimit, siç parashikohet në të drejtën ndërkombëtare dhe atë të brendshme në fuqi.

2. Çdo palë merr përsipër të miratojë ose ruajë masa që synojnë të kapërcejnë pabarazitë për të arritur rezultate të drejta, të ndershme dhe të barabarta, në përputhje me detyrimet e saj të zbatueshme për të drejtat e njeriut, si në nivelin e brendshëm edhe në atë ndërkombëtar, në lidhje me aktivitetet gjatë ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale.

Neni 11
Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave personale

Çdo palë do të miratojë ose ruajë masa për të garantuar që, në lidhje me aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale:

a) të drejtat e privatësisë së individëve dhe të dhënat e tyre personale janë të mbrojtura, duke përfshirë nëpërmjet ligjeve të zbatueshme kombëtare dhe ndërkombëtare, standardeve dhe kornizave; dhe

b) garanci dhe masa mbrojtëse efektive janë vendosur për individët, në përputhje me detyrimet e zbatueshme ligjore të brendshme dhe ndërkombëtare.

Neni 12
Besueshmëria

Çdo palë do të marrë, siç është e përshtatshme, masa për të nxitur besueshmërinë e sistemeve të inteligjencës artificiale dhe besimin në rezultatet e tyre që mund të përfshijnë kërkesa të lidhura me cilësinë dhe sigurinë e duhur gjatë ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale.

Neni 13
Inovacioni i sigurt

Me qëllim që të nxitë inovacionin, ndërsa shmangen ndikimet negative në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës, secilës palë i kërkohet të mundësojë, siç është e përshtatshme, krijimin e mjediseve të kontrolluara për zhvillimin, eksperimentimin dhe testimin e sistemeve të inteligjencës artificiale nën mbikëqyrjen e autoriteteve të saj kompetente.

KREU IV
MJETET JURIDIKE

Neni 14
Mjetet juridike

1. Çdo palë, në masën që mjetet juridike kërkohen nga detyrimet e saj ndërkombëtare dhe janë në përputhje me sistemin ligjor të brendshëm, do të miratojë apo ruajë masa për të garantuar disponueshmërinë e mjeteve juridike të aksesueshme dhe efektive për shkeljet e të drejtave të njeriut që rezultojnë nga aktivitetet brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale.

2. Me synimin për të mbështetur paragrafin 1 të mësipërm, çdo palë do të miratojë ose ruajë masa që përfshijnë:

a) masa për të garantuar që informacioni përkatës, në lidhje me sistemet e inteligjencës artificiale, që kanë potencialin të ndikojnë ndjeshëm në të drejtat e njeriut dhe përdorimi i tyre përkatës është dokumentuar, të ofrohet për organet e autorizuara për t'u njohur me atë informacion dhe kur është e përshtatshme dhe e zbatueshme, të vendoset në dispozicion ose t'i komunikohet personave të prekur;

b) masa për të garantuar që informacioni i referuar në nënparagrafin "a" është i mjaftueshëm për personat e prekur për të kundërshtuar vendimin/et e/të marrë/a ose të informuar kryesisht nga përdorimi i sistemit dhe kur është e rëndësishme dhe e përshtatshme, përdorimin e vetë sistemit; dhe

c) një mundësi efektive për personat e interesuar për të paraqitur një ankesë para autoriteteve kompetente.

Neni 15
Garancitë procedurale

1. Çdo palë do të garantojë që, kur një sistem i inteligjencës artificiale ndikon ndjeshëm në gëzimin e të drejtave të njeriut, garancitë procedurale efektive, garancitë dhe të drejtat, në përputhje me të drejtën e zbatueshme ndërkombëtare dhe të brendshme, të jenë në dispozicion për personat e prekur prej tij.

2. Çdo palë do të kërkojë të garantojë që, në përputhje me kontekstin, personat që ndërveprojnë me sistemet e inteligjencës artificiale të njoftohen se po ndërveprojnë me këto sisteme dhe jo me një njeri/qenie njerëzore.

KREU V
VLERËSIMI DHE ZBUTJA E RREZIQEVE DHE NDIKIMEVE NEGATIVE

Neni 16
Kuadri i menaxhimit të riskut dhe ndikimit

1. Çdo palë, duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në kreun III, do të miratojë ose do të ruajë masa për identifikimin, vlerësimin, parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve të krijuara nga sistemet e inteligjencës artificiale, duke marrë në konsideratë ndikimet aktuale dhe të mundshme në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

2. Këto masa do të vlerësohen dhe diferencohen, sipas rastit, dhe:

a) marrin parasysh kontekstin dhe përdorimin e synuar të sistemeve të inteligjencës artificiale, në veçanti për sa i përket rreziqeve ndaj të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës;

b) marrin parasysh shkallën dhe probabilitetin e ndikimeve të mundshme;

c) marrin në konsideratë, kur është e përshtatshme, perspektivat e palëve të interesuara përkatëse, veçanërisht personat që mund të preken në të drejtat e tyre;

d) zbatohen në mënyrë të përsëritur gjatë të gjithë kohëzgjatjes së aktiviteteve brenda ciklit të jetës së sistemit të inteligjencës artificiale;

e) përfshijnë monitorimin për riskun dhe ndikimet negative ndaj të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës;

f) përfshijnë dokumentimin e rreziqeve, ndikimet aktuale dhe të mundshme dhe qasjen e menaxhimit të riskut; dhe

g) kërkojnë, kur është e përshtatshme, testimin e sistemeve të inteligjencës artificiale përpara se t'i vendosin ato në dispozicion për përdorim për herë të parë dhe kur ato janë të modifikuara ndjeshëm.

3. Çdo palë do të miratojë ose do të ruajë masa që synojnë të garantojnë që ndikimet negative të sistemeve të inteligjencës artificiale mbi të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës të trajtohen në mënyrën e duhur. Këto ndikime negative dhe masat për trajtimin e tyre duhet të

dokumentohen dhe të informojnë masat përkatëse të menaxhimit të riskut të përshkruara në paragrafin 2.

4. Çdo palë do të vlerësojë nevojën për një moratorium ose ndalim, ose masa të tjera të përshtatshme, në lidhje me disa përdorime të sistemeve të inteligjencës artificiale, kur çmon se këto përdorime janë të papajtueshme me respektimin e të drejtave të njeriut, funksionimin e demokracisë ose shtetin e së drejtës.

KREU VI
ZBATIMI I KONVENTËS

Neni 17
Mosdiskriminimi

Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga palët do të garantohet pa diskriminim për çdo lloj shkaku, në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Neni 18
Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të fëmijëve

Çdo palë, në përputhje me të drejtën e saj të brendshme dhe detyrimet ndërkombëtare të zbatueshme, do të marrë parasysh nevojat specifike dhe dobësitë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe të fëmijëve.

Neni 19
Konsultimi publik

Çdo palë do të përpiqet të garantojë që çështjet e rëndësishme të ngritura në lidhje me sistemet e inteligjencës artificiale, sipas rastit, të konsiderohen siç duhet nëpërmjet diskutimit publik dhe konsultimit me shumë pale, duke pasur parasysh pasojat sociale, ekonomike, ligjore, etike, mjedisore dhe ndikime të tjera përkatëse.

Neni 20
Njohuritë dhe aftësitë digjitale

Çdo palë do të inkurajojë dhe nxisë njohuritë dhe aftësitë e duhura digjitale për të gjithë segmentet e popullsisë, duke përfshirë aftësitë specifike të ekspertëve për ata që janë përgjegjës për identifikimin, vlerësimin, parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve të paraqitura nga sistemet e inteligjencës artificiale.

Neni 21
Mbrojtja e të drejtave ekzistuese të njeriut

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të interpretohet si kufizuese, shmangëse apo përndryshe cenuese e të drejtave të njeriut ose të drejtave dhe detyrimeve të tjera ligjore, që mund të garantohen sipas ligjeve përkatëse të një pale, ose ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërkombëtare përkatëse ku ajo është palë.

Neni 22
Mbrojtja më e gjerë

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk do të interpretohet si kufizuese ose që ndikon në ndonjë mënyrë tjetër në mundësinë e një pale për të ofruar një masë mbrojtjeje më të gjerë sesa ajo që parashikohet në këtë Konventë.

KREU VII
MEKANIZMI I MONITORIMIT DHE BASHKËPUNIMIT

Neni 23
Konferenca e palëve

1. Konferenca e palëve do të përbëhet nga përfaqësues të palëve të kësaj Konvente.
2. Palët do të konsultohen periodikisht, me qëllim:
a) lehtësimin e implementimit dhe zbatimit efektiv të kësaj Konvente, duke përfshirë identifikimin e çdo problemi dhe efektet e çdo rezerve të bërë në zbatim të nenit 34, paragrafi 1 ose çdo deklarate të bërë sipas kësaj Konvente;
b) marrjen në konsideratë të plotësimit ose ndryshimit të mundshëm të Konventës;
c) marrjen në konsideratë të çështjeve dhe dhënien e rekomandimeve specifike, në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Konvente;
d) lehtësimin e shkëmbimit të informacionit mbi zhvillimet e rëndësishme ligjore, politike ose teknologjike, duke përfshirë përpjekjet për arritjen e objektivave të përcaktuara në nenin 25, për zbatimin e kësaj Konvente;
e) lehtësimin, kur është e nevojshme, të zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjeve që lidhen me zbatimin e kësaj Konvente; dhe
f) lehtësimin e bashkëpunimit me grupet e interesit, lidhur me aspekte përkatëse të zbatimit të kësaj Konvente, duke përfshirë nëpërmjet seancave dëgjimore publike, kur është e përshtatshme.
3. Konferenca e Palëve do të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës kurdoherë që është e nevojshme dhe në çdo rast, kur shumica e palëve ose Komiteti i Ministrave kërkon thirrjen e saj.
4. Konferenca e Palëve do të miratojë rregullat e saj procedurale me konsensus brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente.
5. Palët do të ndihmohen nga Sekretariati i Këshillit të Evropës në kryerjen e funksioneve të tyre sipas këtij neni.
6. Konferenca e palëve mund t'i propozojë Komitetit të Ministrave mënyrat e duhura për të angazhuar ekspertizën përkatëse, në mbështetje të zbatimit efektiv të kësaj Konvente.
7. Çdo palë që nuk është anëtare e Këshillit të Evropës do të kontribuojë në financimin e aktiviteteve të Konferencës së Palëve. Kontributi i një pale joanëtare të Këshillit të Evropës do të përcaktohet bashkërisht nga Komiteti i Ministrave dhe ai shtet joanëtar.
8. Konferenca e Palëve mund të vendosë që t'i kufizojë pjesëmarrjen në punimet e saj një pale që nuk është më anëtare e Këshillit të Evropës, sipas nenit 8 të Statutit të Këshillit të Evropës (ETS nr. 1) për një shkelje të rëndë të nenit 3 të Statutit. Gjithashtu, mund të merren masa, në lidhje me çdo palë që nuk është anëtare e Këshillit të Evropës me anë të një vendimi të Komitetit të Ministrave për të ndërprerë marrëdhëniet me atë shtet për arsye të ngjashme me ato që përmenden në nenin 3 të Statutit.

Neni 24
Detyrimi për të raportuar

1. Çdo palë do të paraqesë një raport në Konferencën e Palëve brenda dy viteve të para pasi të bëhet palë dhe më pas periodikisht me detaje mbi aktivitetet e ndërmarra për të bërë efektiv nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafët "a" dhe "b".
2. Konferenca e Palëve do të përcaktojë formatin dhe procesin për raportin, në përputhje me rregullat e saj procedurale.

Neni 25
Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Palët do të bashkëpunojnë për realizimin e qëllimit të kësaj Konvente. Palët, më tej, inkurajohen

që, sipas rastit, të ndihmojnë shtetet që nuk janë palë të kësaj Konvente për të vepruar në përputhje me kushtet e kësaj Konvente dhe për t'u bërë palë të saj.

2. Palët, sipas rastit, do të shkëmbejnë informacion të rëndësishëm dhe të dobishëm ndërmjet tyre mbi aspektet që lidhen me inteligjencën artificiale, të cilat mund të kenë efekte të rëndësishme pozitive ose negative në gëzimin e të drejtave të njeriut, funksionimin e demokracisë dhe ruajtjen e shtetit të së drejtës, duke përfshirë risqet dhe efektet që kanë lindur në kontekste kërkimore dhe në lidhje me sektorin privat. Palët inkurajohen që të përfshijnë, siç është e përshtatshme, palët e interesuara përkatëse dhe shtetet që nuk janë palë të kësaj Konvente në këto shkëmbime informacioni.

3. Palët inkurajohen që të forcojnë bashkëpunimin, përfshirë me grupet e interesit kur është e përshtatshme, për të parandaluar dhe zbutur rreziqet dhe ndikimet negative mbi të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës, në kontekstin e aktiviteteve brenda ciklit të jetës së sistemeve të inteligjencës artificiale.

Neni 26
Mekanizmat efektivë të mbikëqyrjes

1. Çdo palë do të krijojë ose caktojë një ose më shumë mekanizma efektivë për të mbikëqyrur përmbushjen e detyrimeve të kësaj Konvente.

2. Çdo palë do të garantojë që këto mekanizma të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, dhe që të kenë kompetencat, ekspertizën dhe burimet e nevojshme për të përmbushur në mënyrë efektive detyrat e tyre të mbikëqyrjes mbi përmbushjen e detyrimeve në këtë Konventë, siç janë zbatuar nga palët.

3. Nëse një palë ka parashikuar më shumë se një mekanizëm të tillë, ajo do të marrë masa, kur është e mundur, për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv ndërmjet tyre.

4. Nëse një palë ka parashikuar mekanizma të ndryshëm nga strukturat ekzistuese të të drejtave të njeriut, ajo do të marrë masa, kur është e mundur, për të nxitur bashkëpunimin efektiv midis mekanizmave të përmendur në paragrafin 1 dhe atyre ekzistuese të brendshme të të drejtave të njeriut.

KREU VIII
KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 27
Efektet e Konventës

1. Nëse dy ose më shumë palë, tashmë, kanë lidhur një marrëveshje ose traktat mbi çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ose kanë krijuar ndryshe marrëdhënie mbi këto çështje, ato do të kenë, gjithashtu, të drejtën që të zbatojnë atë marrëveshje ose traktat, ose të rregullojnë ato marrëdhënie, në përputhje me rrethanat, për sa kohë që e bëjnë këtë në një mënyrë që nuk është në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

2. Palët që janë anëtare të Bashkimit Evropian, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, do të zbatojnë rregullat e Bashkimit Evropian që rregullojnë çështjet brenda fushës së kësaj Konvente, pa cenuar objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente, dhe pa cenuar zbatimin e saj të plotë me palët e tjera. Kjo gjë vlen për palët e tjera në masën që janë të detyruara ligjërisht nga këto rregulla.

Neni 28
Ndryshimet

1. Ndryshimet e kësaj Konvente mund të propozohen nga çdo palë, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ose Konferenca e Palëve.

2. Çdo propozim për ndryshim do t'i komunikohet palëve nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

3. Çdo ndryshim i propozuar nga një palë ose nga Komiteti i Ministrave, do t'i komunikohet Konferencës së Palëve, e cila do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave opinionin e saj mbi ndryshimin e

propozuar.

4. Komiteti i Ministrave do të shqyrtojë ndryshimin e propozuar dhe opinionin e paraqitur nga Konferenca e Palëve, dhe mund të miratojë ndryshimin.

5. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 4, do t'i dërgohet palëve për pranim.

6. Çdo ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 4 do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pasi të gjitha palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tyre.

Neni 29

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të një mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, palët do të kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet negociatave ose mjeteve të tjera paqësore sipas zgjedhjes së tyre, duke përfshirë nëpërmjet Konferencës së Palëve, siç parashikohet në nenin 23, paragrafi 2, nënparagrafi "e".

Neni 30

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe Bashkimi Evropian.

2. Kjo Konventë është objekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën pesë nënshkrues, përfshirë të paktën tri shtete anëtare të Këshillit të Evropës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me këtë Konventë, në përputhje me paragrafin 2.

4. Për çdo nënshkrues që më vonë shpreh pëlqimin e tij për t'u lidhur ligjërisht nga kjo Konventë, ajo do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 31

Anëtarësimi

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, pasi të konsultohet me palët e kësaj Konvente dhe të marrë pëlqimin e tyre unanim, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Evropës, që nuk ka marrë pjesë në hartimin e Konventës, që të aderojë në këtë Konventë me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe me votim unanim të përfaqësuesve të palëve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 32

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet ose Bashkimi Evropian, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të specifikojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo palë, në një datë të mëvonshme, me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente për çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason

përfundimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mëparshëm, në lidhje me çdo territor të specifikuar në atë deklaratë, mund të tërhiqet me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja do të bëhet efektive në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 33
Klauzola federale

1. Një shtet federal mund të rezervojë të drejtën për të marrë përsipër detyrimet sipas kësaj Konvente, në përputhje me parimet e tij themelore që rregullojnë marrëdhënien midis qeverisë së tij qendrore dhe shteteve përbërëse ose entiteteve territoriale të ngjashme, me kusht që kjo Konventë të zbatohet për qeverinë qendrore të shtetit federal.

2. Në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave i përket juridiksionit të shteteve përbërëse ose entiteteve territoriale të ngjashme, që nuk janë të detyruara nga sistemi kushtetues i federatës të marrin masa legjislative, qeveria federale do t'i informojë autoritetet përkatëse të këtyre shteteve për këto dispozita me opinionin e saj të favorshëm dhe do t'i inkurajojë që të ndërmarrin veprime të përshtatshme për t'i zbatuar ato.

Neni 34
Rezervat

1. Me një njoftim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, çdo shtet, në momentin e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë përdorimin e rezervës së parashikuar në nenin 33, paragrafi 1.

2. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet në lidhje me këtë Konventë.

Neni 35
Denoncimi

1. Çdo palë mund të denoncojë në çdo kohë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Ky denoncim do të bëhet efektiv në ditën e parë të muajit që pason përfundimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 36
Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'u njoftojë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, shteteve që nuk janë anëtare por që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, Bashkimit Evropian, çdo nënshkruesi, çdo shteti kontraktues, çdo pale dhe çdo shteti tjetër që është ftuar të aderojë në këtë Konventë, për:

a) çdo nënshkrim;

b) depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;

c) çdo datë hyrjeje në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 30, paragrafët 3 dhe 4, dhe nenin 31, paragrafi 2;

d) çdo ndryshim të miratuar në përputhje me nenin 28 dhe datën kur ky ndryshim hyn në fuqi;

e) çdo deklaratë të bërë sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi "b";

f) çdo rezervë dhe tërheqjen e një rezerve të bërë sipas nenit 34;

g) çdo denoncim të bërë sipas nenit 35;

h) çdo akt tjetër, deklaratë, njoftim ose komunikim që lidhet me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e mëposhtëm, duke qenë të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Vilnius, në datën 5 shtator 2024, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Evropës, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, Bashkimit Evropian dhe çdo shteti të ftuar që të aderojë në këtë Konventë.

DEKRET
Nr. 512, datë 6.10.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 93/2026, "Për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës".

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj